<p>Dorëshkrimi ose ekzemplari tjetër original që i është dorëzuar botuesit duhet patjetër t'i kthehet autorit, përveç artikujve, vizatimeve dhe kontributeve tjera në shtypin ditor dhe në atë periodik, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.</p> <p style="text-align: center;">Neni 92 E drejta e përparësisë së botuesit</p> <p>1. Botuesi i cili ka marrë të drejtën për botimin e veprës në formë të librit, ka të drejtën e përparësisë që, krahas ofertuesve tjerë të barabartë, ta botojë atë vepër në formë elektronike.</p> <p>2. E drejta e përparësisë nga paragrafi 1 i këtij neni zgjat tre vjet që nga dita e kontraktimit të datës së botimit të veprës. Botuesi duhet të deklarohet në formë të shkruar brenda 30 ditësh që nga dita e marrjes së ofertës me shkrim nga autori.</p> <p style="text-align: center;">Neni 93 Shkatërrimi i ekzemplarëve të pashitur</p> <p>Nëse botuesi synon që ekzemplarët e pashitur të veprës t'i shesë si letër të vjetër,</p>	<p>Manuscript and other original patterns handed over to the publisher, shall be returned to author by all means, except articles, cartoons, and other contributions in daily and periodic press, if not otherwise provided by such contract.</p> <p style="text-align: center;">Article 92 The right of publisher's priority</p> <p>1. The publisher who acquired the right to publish the work in book mode holds the right of priority that along other equal bidders, to publish such work in electronic way.</p> <p>2. The right for priority referred to in paragraph 1 of this article shall run for three years from the day of contracting the publishing date. The publisher shall declare in written within 30 days from the day of receiving the offer in written from the author.</p> <p style="text-align: center;">Article 93 Extermination of unsold copies</p> <p>If the publisher aims to sell the unsold copies of work as an old paper, he is</p>	<p>Rukopis ili neki originalan koji je predat izdavaču treba obavezno da se vrati autoru, osim članaka, crteža i ostalih doprinosa u dnevim novinama i onim periodičnim, ako se ugovorom drugačije ne predviđa.</p> <p style="text-align: center;">Član 92 Pravo prednosti izdavača</p> <p>1. Izdavač koji je dobio pravo za izdavanje dela u obliku knjige, ima pravo prednosti da, uporedo ostalih jednakih ponudiocima, to delo objavi u elektronskom obliku.</p> <p>2. Pravo na prednost iz paragrafa 1 ovog člana, traje tri godine, od dana ugovaranja datuma za izdavanje dela. Izdavač treba da se izjasni, u pisanoj formi, unutar 30 dana, od dana primanja pisane ponude od autora.</p> <p style="text-align: center;">Član 93 Uništavanje neprodatih primeraka</p> <p>Ako izdavač teži da neprodane primerke dela proda kao stari papir, obavezan je da</p>
--	---	---



<p>është i detyruar që blerjen paraprakisht t'ia ofrojë autorit, nëse rëndom është i arritshëm, sipas çmimit për letër të thjeshtë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 94 Shkatërrimi i veprës nga fuqia madhore</p> <p>1. Nëse i vetmi ekzemplar ekzistues i veprës shkatërrohet nga shkaku i fuqisë madhore pasi t'i jetë dorëzuar botuesit, autori ka të drejtë në kompensim, siç do t'i takonte po të ishte botuar vepra.</p> <p>2. Nëse nga shkaku i fuqisë madhore është shkatërruar i tërë tirazhi i përgatitur i veprës, para se të jetë nxjerrë në treg, botuesi ka të drejtë të përgatisë botimin e ri, ndërsa autorit i takon kompensimi vetëm për botimin e shkatërruar.</p> <p>3. Nëse nga shkaku i fuqisë madhore është shkatërruar një pjesë e tirazhit të veprës, para se të jetë nxjerrë në treg, botuesi ka të drejtë pa pagesë shtesë të kompensimit të shumëzuar po aq ekzemplarë sa janë shkatërruar.</p>	<p>obliged to offer it first to the author, according to the price for simple paper.</p> <p style="text-align: center;">Article 94 Extermination of work from force majeure</p> <p>1. If the only existing copy of work is exterminated by cause of force majeure after has been submitted to the author, the author holds the right for the same compensation, as if such work had been published.</p> <p>2. If as a result of cause of force majeure, the entire edition was exterminated before launched in market, the publisher has the right to prepare a new publication, and the author is entitled to compensation for the exterminated publication.</p> <p>3. If as a result of cause of force majeure a part of edition is exterminated before launched in the market, the publisher has the right without additional pay to multiply the same number of copies with the number of exterminated ones.</p>	<p>kupovinu najpre ponudi autoru, ako je uobičajeno dostupan, prema ceni običnog papira.</p> <p style="text-align: center;">Član 94 Uništavanje dela od prirodnih nepogodnosti</p> <p>1. Ako se jedini postojeći primerak uništi od prirodnih nepogoda, nakon što je predat izdavaču, autor ima pravo na kompenzaciju, onako kako bi mu pripadalo ako bi se delo objavilo.</p> <p>2. Ako se iz razloga prirodnih nepogoda uništio kompletan pripremljen tiraž dela, pre nego je izbačen na tržište, izdavač ima pravo da pripremi novo izdanje, dok, autoru pripada kompenzacija samo za uništeno izdanje.</p> <p>3. Ako se iz razloga prirodnih nepogoda uništio jedan deo pripremljenog tiraža dela, pre nego je izbačeno na tržište, izdavač ima pravo, bez dodatne kompenzacije, da umnoži isti broj primeraka, koliko ih je uništeno.</p>
---	--	--



Neni 95 Përfundimi i kontratës	Article 95 Termination of contract	Član 95 Završavanje ugovora
<p>Kontrata e botimit përfundon:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Nëse autori vdes para përfundimit të veprës;2. Nëse ekzemplarët e të gjitha tirazheve të kontraktuara janë shitur;3. Me skadimin e afatit të kohëzgjatjes së kontratës;4. Me zgjidhjen e kontratës në përputhje me ligjin mbi detyrimet.	<p>Publishing contract terminates:</p> <ol style="list-style-type: none">1. if the author dies before the completion of work;2. if the copies of all contracted editions are sold;3. when the term of contract expires;4. when annulling the contract in accordance with law on obligation.	<p>Ugovor o izdavnju se završava:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Ako autor umre pre završavanja dela;2. Ako su primeri svih ugovorenih tiraža prodati;3. Skadencijom roka o trajanju ugovora;3. Rešavanjem ugovora u saglasnosti zakona o obavezama.4.
Neni 96 Zgjidhja e kontratës	Article 96 Annulling of contract	Član 96 Razrešenje ugovora
<ol style="list-style-type: none">1. Nëse botuesi nuk e boton veprën brenda afatit të kontraktuar ose brenda afatit nga paragrafi 1 i nenit 89 të këtij Ligji, autori ka të drejtë ta zgjidhë kontratën e botimit, të mbajë, përkatësisht të kërkojë pagesën e kompensimit të caktuar, si dhe të kërkojë dëmshpërblimin.2. Autori mund ta zgjidhë kontratën e botimit në rast se botuesi, pasi të jetë shitur tirazhi i botimit paraprak ndërkaq kontrata përmban detyrimin për ribotime, nuk fillon të nxjerrë në treg ekzemplarët e botimit të ardhshëm brenda afatit nga 1 të nenit 89 të	<ol style="list-style-type: none">1. If the publisher does not publish the work within the contracted term or within the term referred to in paragraph 1 of the present article, the author has the right to annul the publishing contract, to retain respectively to request the remuneration pay and indemnity.2. The author can annul the publishing contract if the publisher after having sold the edition of preeliminary publication, although the contract includes the obligation for re-publication, does not initiate the launching in market of copies	<ol style="list-style-type: none">1. Ako izdavač ne izda delo u ugovornom roku ili unutar roka, iz paragrafa 1 člana 89 ovog zakona, autor ima pravo da razreši ugovor o izdanju, da zadrži, odnosno zahteva plaćanje određene kompenzacije, kao i da traži odštetu.2. Autor može da razreši ugovor o izdanju u slučaju da izdavač, nakon što je tiraž prethodnog izdanja prodat, dok, ugovor sadrži obaveze za ponovno objavljivanje, ne počne da izlaže na tržište primerke sledećeg izdanja, unutar roka, iz paragrafa



<p>këtij Ligji.</p> <p>3. Botuesi mund të zgjidhë kontratën e botimit nëse autori nuk ia dorëzon dorëshkrimin ose një ekzemplar tjetër të veprës brenda afatit nga paragrafi 1 të nenit 89 të këtij Ligji.</p> <p>4. Konsiderohet se tirazhi i botimit është shitur nëse numri i ekzemplarëve të pashitur është më i vogël se 100.</p> <p style="text-align: center;">Neni 97 Kontrata e shfaqjes dhe kontrata e interpretimit</p> <p>Me kontratën për shfaqjen, përkatësisht kontratën për interpretimin e veprës, autori ia kalon shfrytëzuesit të drejtën për të shfaqur, përkatësisht për të interpretuar publikisht veprën e tij, ndërsa shfrytëzuesi merr detyrimin që atë veper ta shfaqë, përkatësisht ta interpretojë publikisht në afatin e caktuar, në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me kontratë, dhe për këtë t'i paguajë autorit kompensimin.</p>	<p>of future publication within the term referred to in paragraph 1 of article 89 of this law.</p> <p>3. The publisher can annul the contract if the author does not submit the manuscript or another copy of work within the term referred to in paragraph 1 of article 89 of this law.</p> <p>4. The edition is considered as sold if the number of unsold copies is less than 100.</p> <p style="text-align: center;">Article 97 The contract on presentation and interpretation</p> <p>The contract on presentation respectively interpretation of author's work shall specify the right of the user to present respectively to perform publically his work, and the user takes the responsibility that such work is publically interpreted within the specified term, according to the way and conditions provided by contract and pay the compensation to the author.</p>	<p>1 člana 89 ovog zakona.</p> <p>3. Izdavač može da razreši ugovor o izdavanju, ako mu autor ne preda rukopis ili neki drugi primerak dela, unutar roka iz paragrafa 1 člana 89 ovog zakona.</p> <p>4. Smatra se da se tiraž izdanja prodao, ako je broj neprodatih primeraka manji od 100.</p> <p style="text-align: center;">Član 97 Ugovor o predstavi i ugovor o interpretiranju</p> <p>Ugovorom o predstavi, odnosno ugovorom o interpretiranju autorskog dela, prenosi se korisniku pravo na predstavu, odnosno da javno interpretira njegovo delo, dok, korisnik preuzima obavezu da to delo predstavi, odnosno javno interpretira u određenom roku, na način i uslovima određenim ugovorom i, da autoru plati kompenzaciju.</p>
--	---	--



<p style="text-align: center;">Neni 98</p> <p>Të drejtën e shfaqjes, përkatësisht të drejtën e interpretimit publik të veprës, autori mund ta kalojë njëkohësisht në disa persona, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.</p>	<p style="text-align: center;">Article 98</p> <p>The author can assign the right of presentation respectively the right of public interpretation of work simultaneously to several persons, if not otherwise provided by contract.</p>	<p style="text-align: center;">Član 98</p> <p>Pravo na predstavu, odnosno pravo na javno interpretiranje dela, autor može istovremeno da prenese na nekoliko osoba, ako se ugovorom drugačije ne predvidi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 99</p> <p>Bartësi i të drejtës në shfaqjen apo interpretimin publik të veprës teatrore, teatrore-muzikore dhe koreografike lidhë edhe kontratë për regjinë teatrore, koreografinë, skenografinë dhe kostumografinë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 99</p> <p>The right holder of public presentation or interpretation of theatrical, theatrical-musical and choreographic work concludes contract on theatrical director, choreography, scenography and costumography.</p>	<p style="text-align: center;">Član 99</p> <p>Nosioc prava na predstavu ili javno interpretiranje pozorišnog, pozorišno-muzičkog i koreografskog dela, sklapa ugovor za pozorišnu, koreografsku, scenografsku i kostimografsku režiju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 100</p> <p>Nëse autori nuk ia dorëzon shfrytëzuesit veprën, brenda afatit të kontraktuar, shfrytëzuesi mund të zgjidhë kontratën dhe të kërkojë dëmshpërblim.</p>	<p style="text-align: center;">Article 100</p> <p>If the author does not submit his work to user within the contracted term, the user can annul the contract and ask for indemnity.</p>	<p style="text-align: center;">Član 100</p> <p>Ako autor ne preda korisniku delo, unutar ugovorenog roka, korisnik može da razreši ugovor i da zahteva oštećenje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 101</p> <p>Dorëshkrimi, partitura ose origjinali tjetër i veprës që është objekt i kontratës i kthehen autorit, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.</p>	<p style="text-align: center;">Article 101</p> <p>Manuscript, scores or other originals of work subject to contract shall be returned to the author if not otherwise provided by contract.</p>	<p style="text-align: center;">Član 101</p> <p>Rukopis, partitura ili drugi original dela, koji je objekat ugovora, vraća se autoru, ako se ugovorom drugačije ne predvidi.</p>



<p style="text-align: center;">Neni 102</p> <p>Shfrytëzuesi detyrohet t'ia mundësojë autorit përcjelljen dhe ecurinë e përgatitjeve për shfaqjen, përkatësisht interpretimin e veprës, të kujdeset për kushtet përkatëse teknike për shfaqjen, përkatësisht interpretimin e veprës, si dhe t'i dërgojë autorit ose përfaqësuesit të tij programin dhe herë pas here ta informojë për të ardhurat nga shfaqja, përkatësisht interpretimi i veprës.</p>	<p style="text-align: center;">Article 102</p> <p>The user is obliged to enable the author to follow the flow of preparations regarding the presentation respectively interpretation of work, to ensure the technical conditions and submit the programme to the author or his representative and occasionally inform for the incomes from presentation respectively interpretation of work.</p>	<p style="text-align: center;">Član 102</p> <p>Korisnik se obavezuje da omogući autoru praćenje toka pripreme za predstavu, odnosno interpretiranje dela, da brine o dotičnim tehničkim uslovima za predstavu, odnosno interpretiranje dela, kao i da pošalje autoru ili njegovom predstavniku, program i da ga, s vremena na vreme, informiše o prihodima sa predstave, odnosno interpretiranje dela.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 103</p> <p>Nëse shfrytëzuesi nuk e shfaq, përkatësisht nuk e interpreton veprën në afatin e kontraktuar, autori mund ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë dëmshpërblim, e pos kësaj mund të mbajë kompensimin e paguar, respektivisht të kërkojë pagesën e kompensimit të kontraktuar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 103</p> <p>If the user does not present or interpret the work within the contracted term, author can annul related contract and ask for indemnity, and in addition he can retain the compensation paid, which means to require the payment of contracted compensation</p>	<p style="text-align: center;">Član 103</p> <p>Ako korisnik ne prikaže predstavu, odnosno ne interpretira delo u ugovorenom roku, autor može da razreši ugovor i zahteva oštećenje, osim ovoga on može da zadrži isplaćenu kompenzaciju, odnosno da zahteva isplaćivanje ugovorene kompenzacije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 104 Kontrata e përpunimit të veprës</p> <p>Me kontratën për përpunimin e veprës së autorit, autori e kalon të drejtën për t'u përpunuar vepra e tij në formën e</p>	<p style="text-align: center;">Article 104 The contract on work processing</p> <p>By the contract on work processing of the author, the author assigns the right for his work to be published in the mode of scenic</p>	<p style="text-align: center;">Član 104 Ugovor o obrađivanju dela</p> <p>Ugovorom o obrađivanju autorskog dela, autor prenosi pravo da se njegovo delo obradi u obliku scenske adaptacije,</p>



<p>përshtatjes skenike, përshtatjes audiovizuele ose për mënyra të tjera të shfrytëzimit të veprës në formë të ndryshuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 105 Kontrata e porosisë së veprës së autorit</p> <p>1. Me kontratën për porosi të veprës së autorit, autori merr detyrimin që për porositësin të krijojë veprën e autorit dhe t'ia dorëzojë origjinalin ose ekzemplarën e veprës, ndërsa porositësi merr detyrimin që autorit t'ia paguajë kompensimin.</p> <p>2. Porositësi mund të mbikëqyrë procesin e krijimit të veprës dhe të japë udhëzime, por duke mos ndërhyrë në lirinë e shprehjes artistike apo shkencore të autorit.</p> <p>3. Porositësi gëzon të drejtën e publikimit dhe të shpërndarjes së veprës, ndërsa autori ruan të drejtat tjera, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.</p> <p>4. Dispozitat e këtij neni zbatohen ngjashëm dhe aq sa i takon <i>mutatis mutandis</i> edhe ndaj veprës që autori e ka krijuar si fitues i konkursit publik.</p> <p>5. Ndaj kontratës për porosi të veprës së</p>	<p>adaption, audiovisual adaption or of other modes of use of work in modified form.</p> <p style="text-align: center;">Article 105 The contract on request of author's work</p> <p>1. Through the contract for requesting the author's work, the author takes the obligation to create for the requester an author's work and to submit to him the original or copy of work, and the requester is obliged to pay remuneration to the author.</p> <p>2. The requester can supervise the process of creating the work and provide instruction, without interfering in the freedom of artistic or scientific expression of author.</p> <p>3. The requester enjoys the right of publication and distribution of work and the author retains other rights, if not otherwise provided by contract.</p> <p>4. Provisions of this article shall apply similarly <i>mutatis mutandis</i> also for the work that author created as a winner of public competition.</p> <p>5. The general provisions of the right of</p>	<p>audiovizuelnim prilagođavanjem ili za druge načine korišćenja dela u promenjenom obliku.</p> <p style="text-align: center;">Član 105 Ugovor o narudžbini autorskog dela</p> <p>1. Ugovorom o narudžbini autorskog dela, autor preuzima obavezu da za naručioca stvori autorsko delo i da mu preda original ili primerak dela, dok naručioc preuzima obavezu da autoru plati kompenzaciju.</p> <p>2. Naručioc može da nadzire proces stvaranja dela i da daje uputstva ali, ne ulazeći u slobodu umetničkog ili naučnog izražavanja autora.</p> <p>3. Naručioc uživa pravo objave i raspodele dela, dok autor zadržava ostala prava, ako se ugovorom drugačije ne predvidi.</p> <p>4. Dispozicije ovog člana se sprovode slično i onoliko koliko pripada <i>mutatis mutandis</i> i prema delu koje je autor stvorio, kao dobitnik javnog konkursa.</p> <p>5. Prema ugovoru o narudžbini autorskog</p>
---	--	---



<p>autorit zbatohen dispozitat e përgjithshme të të drejtës së detyrimeve, në mënyrë analoge, që kanë të bëjnë për kontratë për veprë, nëse me këtë Ligj nuk parashihet ndryshe.</p> <p style="text-align: center;">Neni 106 Kontrata e veprës kolektive të autorit</p> <p>1. Vepra kolektive e autorit është veprë e krijuar në bashkëpunim të disa autorëve, duke gërshtuar kontributet e tyre veç e veç në një tërësi siç janë: enciklopeditë, leksikonet, bazat e të dhënave, programet kompjuterike, koleksionet dhe veprat tjera të ngjajshme me iniciativën dhe nën drejtimin e një personi fizik apo juridik si porositës i veprës.</p> <p>2. Për krijimin e një vepre kolektive lidhet kontratë e veçantë. Nëse nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni kontrata e tillë është e pavlefshme.</p> <p>3. Konsiderohet se porositësit i është bërë kalimi i pakufizuar dhe ekskluziv i të gjitha të drejtave pasurore dhe i të drejtave tjera të autorit në veprën kolektive, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.</p>	<p>obligations apply for the contract on the request of work similarly, if not otherwise provided by his law.</p> <p style="text-align: center;">Article 106 Contract of collective works of the author</p> <p>1. The collective work of author is the work created in cooperation of several authors, by combining their contribution separately into a work such as: encyclopedies, lexicons, database, computer programs, collections and other similar works, with the initiative and guidance of a natural person or legal entity as a requester of work.</p> <p>2. In order to create a collective work, a special contract shall be concluded. If the conditions referred to in paragraph 1 are not fulfilled, such contract is not valid.</p> <p>3. If not otherwise provided by contract, it is considered that the requester has been assigned with all unlimited and exclusive property rights and other author's rights of the collective work.</p>	<p>dela, sprovode se opšte dispozicije prinudnog prava, na analogan način, onih koji se tiču ugovora o delu, ako ovim zakonom drugačije ne predvidi.</p> <p style="text-align: center;">Član 106 Ugovor o kolektivnom delu autora</p> <p>1. Kolektivno autorsko delo je delo, stvoreno u saradnji nekoliko autora, spajajući njihove doprinose ponaosob, u jenu celinu, kao što su: enciklopedije, leksikoni, baze podataka, kompjuterski programi, kolekcije i ostala slična dela, sa inicijativom i pod upravljanjem jednog fizičkog ili pravnog lica, kao naručioca dela.</p> <p>2. Za stvaranje kolektivnog dela sklapa se poseban ugovor. Ako se nisu ispunili uslovi iz paragrafa 1 ovog člana, takav ugovor je bezvredan.</p> <p>3. Smatra se da se naručiocu izvršio neograničen i ekskluzivan prenos, svih imovinskih prava i ostalih autorskih prava u kolektivnom delu, ako se ugovorom drugačije ne predvidi.</p>
--	---	---



<p>4. Porositësi i veprës kolektive të autorit gëzon të drejtën për ta publikuar dhe shfrytëzuar veprën në emrin e vet, por në çdo ekzemplar të veprës duhet patjetër të jetë vënë lista e autorëve pjesëmarrës në krijimin e veprës kolektive.</p>	<p>4. The requester of collective work of author enjoys the right to publish and use the work under his own name, however in each copy of work the list of participating authors shall be placed.</p>	<p>4. Naručioc kolektivnog dela autora uživa pravo na objavljivanje i korišćenje dela u svoje ime ali, u svakom primerku dela, treba da se postavi lista autora učesnika na stvaranju kolektivnog dela.</p>
<p style="text-align: center;">Nënkreu J</p> <p style="text-align: center;">DISPOZITA TË VEÇANTA PËR DISA VEPRA TË AUTORIT</p> <p style="text-align: center;">Neni 107</p> <p style="text-align: center;">E drejta e përshtatjes audiovizuele</p>	<p style="text-align: center;">Subchapter J</p> <p style="text-align: center;">SPECIAL PROVISIONS REGARDING SOME AUTHOR'S WORKS</p> <p style="text-align: center;">Article 107</p> <p style="text-align: center;">The right of audiovisual adaptation</p>	<p style="text-align: center;">Poglavlje J</p> <p style="text-align: center;">POSEBNE DISPOZICIJE ZA NEKA AUTORSKA DELA</p> <p style="text-align: center;">Član 107</p> <p style="text-align: center;">Pravo na audiovizuelnu adaptaciju</p>
<p>1. Me kontratë të përshtatjes audiovizuele të veprës së autorit, autori ia kalon producentit të filmit të drejtën ekskluzive të përpunimit të veprës së tij burimore, për ta xhiruar dhe shfrytëzuar si vepër audiovizuele.</p> <p>2. Konsiderohet se autori i veprës burimore ia kalon ekskluzivisht dhe pa kufizime producentit të filmit të drejtën e përshtatjes së veprës burimore në vepër audiovizuele, të gjitha të drejtat pasurore dhe të drejtat e tjera të autorit në atë vepër audiovizuele, përkthimet si dhe përshtatjet audiovizuele të saj, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.</p> <p>3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2</p>	<p>1. By the contract of audiovisual adaptation of author's work, the author assigns to the film producer the exclusive right of processing his source work, to record and use it as audiovisual work.</p> <p>2. If not otherwise provided by contract, it is considered that the author of source work assigns exclusively and without limitations to the film producer the right of adaptation of source work into audiovisual work, all property rights and other author's rights, translations as well as its audiovisual adaptations.</p> <p>3. Regardless the provisions referred to in</p>	<p>1. Ugovorom o audiovizuelnoj adaptaciji autorskog dela, autor prenosi filmskom producentu ekskluzivno pravo na obradu njegovog izvornog dela, da bi se snimilo i iskoristilo kao audiovizuelno delo.</p> <p>2. Smatra se da autor izvornog dela, ekskluzivno i bez ograničenja, prenosi na filmskog producenta, pravo za adaptaciju izvornog dela u audiovizuelno delo, sva imovinska prava i ostala autorska prava na tom audiovizuelnom delu, njegovom prevodu i audiovizuelnoj adaptaciji, ako se ugovorom drugačije ne predvidi.</p> <p>3. Nezavisno od dispozicijisa iz paragrafa 2</p>



<p>të këtij neni autori i veprës burimore ruan:</p> <p>3.1. Të drejtën ekskluzive për përpunim të mëtejshëm të veprës audiovizuale në një formë tjetër artistike.</p> <p>3.2. Të drejtën ekskluzive për të lejuar një përshtatje të re audiovizuale të veprës burimore të tij, por pasi të kenë kaluar dhjetë vjet që nga dita e lidhjes së kontratës nga paragrafi 2 i këtij neni.</p> <p>3.3. Të drejtën e kompensimit përkatës nga producenti i filmit, për çdo qiradhënie të videogramave të veprës audiovizuale.</p> <p>4. Autori i veprës burimore nuk mund të heqë dorë nga e drejta e tij sipas paragrafit 3 të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 108 Supozimi i kalimit</p> <p>Nëse një vepër burimore është krijuar nga dy apo më shumë bashkautorë, dhe vetëm njëri prej tyre e ka dhënë të drejtën e përshtatjes audiovizuale, ndërsa bashkautorit tjetër vetëm ka marrë pjesën e vet të pagesës së kompensimit,</p>	<p>paragraph 2 of this article the author of source work retains:</p> <p>3.1. The exclusive right for further processing of audiovisual work in another artistic form.</p> <p>3.2. The exclusive right to allow a new audiovisual adaptation of source work, but only after ten years have passed from the date of contract is concluded as referred to in paragraph 2 of this article.</p> <p>3.3. The right of relevant remuneration from the film producer for every leasing of videograms of audiovisual works</p> <p>4. The author of source work can not resign from his right as referred to in paragraph 3 of this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 108 Presumption of assignment</p> <p>If a source work is created by two or more co-authors and only one of them has assigned his right to audiovisual adaptation, whereas the other or others have received their portion of the royalty, it shall be presumed that the other co-</p>	<p>ovog člana, autor izvornog dela čuva:</p> <p>3.1. Ekskluzivno pravo za dalju preradu audiovizuelnog dela u neki drugi umetnički oblik.</p> <p>3.2. Ekskluzivno pravo da dozvoli neku novu audiovizuelnu adaptaciju njegovog izvornog dela ali, tek nakon isteka deset godina, od sklapanja ugovora, iz paragrafa 2 ovog člana.</p> <p>3.3. Pravo na adekvatnu kompenzaciju od filmskog producenta, za svako uznajmljivanje videograma audiovizuelnog dela.</p> <p>4. Autor izvornog dela ne može odustati od svog prava prema paragrafu 3 ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 108 Pretpostavka prenosa</p> <p>Ako se jedno izvorno delo stvorilo od dva ili više ko- autora, ali, samo jedan od njih daje pravo na audiovizuelnu adaptaciju, dok je drugi ko-autor, dobio svoj deo isplate za kompenzaciju, smatra se da je i drugi ko-autor, prećutno dao svoje pravo.</p>
--	--	--



<p>konsiderohet se edhe bashkautorit tjetër e ka dhënë në heshtje të drejtën e tij.</p> <p style="text-align: center;">Neni 109</p> <p>Për kalimin e mëtejshëm të të drejtës së fituar për përshtatje nuk nevojitet autorizimi i autorit në rastet kur producenti i filmit nuk është në gjendje ta përfundojë me sukses veprën.</p>	<p>author or co-authors have assigned their rights in silence.</p> <p style="text-align: center;">Article 109</p> <p>For further assignment of the right for adaptation, the author's authorisation is not needed in cases when the film producer is not able to complete the work successfully.</p>	<p style="text-align: center;">Član 109</p> <p>Za dalji prenos dobijenog prava za adaptaciju nije potrebno ovlašćenje autora, u slučajevima kada filmski producent nije u stanju da uspešno završi delo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 110</p> <p>1. Nëse me kontratë nuk është parashikuar ndryshe, konsiderohet se producenti i filmit ka të drejtë që titullin e veprës së përshtatur ta përdorë për titull të veprës audiovizuale.</p> <p>2. Autori i veprës burimore, nëse kërkon, ka të drejtë që emri i tij dhe njoftimi se vepra audiovizuale është bërë sipas veprës së tij, të shënohen në afishe, programe të kinemasë dhe mjete të tjera reklamuese.</p>	<p style="text-align: center;">Article 110</p> <p>1. If not otherwise provided by contract, it shall be presumed that the film producer has the right to use the title of adapted audiovisual work for the title of audiovisual work.</p> <p>2. The author of source work, has the right to request that his name and the notification that the audiovisual work is done based on his work, are written in posters, cinema programmes and other advertising means.</p>	<p style="text-align: center;">Član 110</p> <p>1. Ako se ugovorom nije drugačije predvidelo, smatra se da filmski producent ima pravo da naslov adaptiranog dela iskoristi kao naslov audiovizuelnog dela.</p> <p>2. Autor izvorno dela, ako zahteva, ima pravo da njegovo ime i informacija da je audiovizuelno delo izvršeno prema njegovom delu, da se napiše u oglasu, filmskim programima i ostalim reklamnim sredstvima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 111</p> <p>Kontrata e përshtatjes audiovizuale mund të përmbajë klauzolën mbi atë se autori i veprës burimore ka të drejtë ta shikojë</p>	<p style="text-align: center;">Article 111</p> <p>The contract of audiovisual adaptation can include a clause specifying that the author of source work has the right to see the</p>	<p style="text-align: center;">Član 111</p> <p>Ugovor o audiovizuelnoj adaptaciji može sadržiti klauzolu o tome da, autor izvornog dela, ima pravo da pogleda scenario, pre</p>



<p>skenarin para fillimit të produksionit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 112 Bashkautorët e veprës audiovizuele</p> <p>1. Vepra audiovizuele është tërësi e mëvetësishme e kontributeve krijuese të bashkautorëve që kanë bashkëpunuar në bërjen e saj, si dhe vepër në të cilën mishërohen kontributet e autorëve të tjerë, por që nuk konsiderohen si bashkautorë.</p> <p>2. Bashkautorë të veprës audiovizuele konsiderohen: autori i përshtatjes, autori i skenarit, autori i dialogjeve, drejtori i fotografisë dhe regjisori kryesor.</p> <p>3. Nëse muzika është kompozuar enkas për atë vepër bashkautor i veprës është edhe kompozitori.</p> <p>4. Nëse animacioni përbën element thelbësor të veprës audiovizuele bashkautor i kësaj vepre konsiderohet edhe animatori kryesor.</p> <p>5. Kompozitori i muzikës dhe animatori, përkatësisht vizatuesi që nuk konsiderohen bashkautorë të veprës sipas paragrafit 3 dhe 4 të këtij neni, si dhe skenografi, kostumografi, piktori i grimit dhe</p>	<p>screenplay before the beginning of production.</p> <p style="text-align: center;">Article 112 Coauthors of audiovisual work</p> <p>1. Audiovisual work is an independent integrity of creative contributions of co-authors as well as a work in which contributions of other authors are embodied but they are not considered as coauthors.</p> <p>2. Coauthors of audiovisual works are considered: the author for adaptation, the author of dialogues, the director of photography and the main director.</p> <p>3. If the music is composed specially for that work, the composer shall be considered as co-author of such work.</p> <p>4. If the animation constitutes an essential element of the audiovisual work, the main animator is considered to be co-author of that work.</p> <p>5. Music composer and animator that are not considered coauthors of work according to paragraph 3 and 4 of this article , as well as scenograph, costumograph, makeup artist and editor are considered authors of</p>	<p>početka produkcije.</p> <p style="text-align: center;">Član 112 Ko-autori audiovizuelnog dela</p> <p>1. Audiovizuelno delo je samostalna stvaralačka celina doprinosna ko-autora, koji su sarađivali u njenom stvaranju kao i delo u kome se utelovljuju doprinosi ostalih autora ali, koji se ne smatraju ko-autorima.</p> <p>2. Ko-autori audiovizuelnog dela se smatraju: autor adaptacije, scenarijski autor, autor dialoga, direktor fotografije i glavni režiser.</p> <p>3. Ako se muzika komponovala posebno za to delo, ko-autor dela je i kompozitor.</p> <p>4. Ako animacija čini suštinski element audiovizuelnog dela, ko-autor ovog dela će se smatrati i glavni animator.</p> <p>5. Kompozitor muzike i animator, odnosno crtač, koji se ne smatraju ko-autorima dela, prema paragrafu 3 i 4 të ovog člana kao i scenograf, kostimograf, šminker i montažer, smatraju se autorima dotičnih</p>
---	--	---



<p>montazheri, konsiderohen autorë të kontributeve përkatëse në veprën e autorit.</p>	<p>related contributions in the author's work.</p>	<p>doprinosa u autorskom delu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 113 Kontrata e prodhimit të filmit</p>	<p style="text-align: center;">Article 113 Contract of film production</p>	<p style="text-align: center;">Član 113 Ugovor o filmskoj proizvodnji</p>
<p>1. Marrëdhëniet e ndërsjella të producentit të filmit me autorët e veprës audiovizuele dhe autorët e kontributeve, si dhe marrëdhëniet midis vetë bashkautorëve rregullohen me anë të kontratës për prodhim të filmit.</p> <p>2. Me kontratën e prodhimit të filmit autorët e veprës audiovizuele dhe autorët e kontributeve marrin përsipër detyrimin ndaj producentit të filmit për të bashkëpunuar në mënyrë krijuese në krijimin e veprës audiovizuele, dhe ia kalojnë të gjitha të drejtat e tyre pasurore mbi atë vepër, ndërkaq producenti i filmit merr përsipër detyrimin për t'iu paguar kompensimin e autorit.</p> <p>3. Me lidhjen e kontratës për prodhimin e filmit, konsiderohet se bashkautorët dhe autorët e kontributeve, në mënyrë ekskluzive dhe pa kufizime, ia kalojnë producentit të filmit të gjitha të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit mbi veprën audiovizuele, përkthimet e saj në</p>	<p>1. Mutual relations between film producer and the authors of audiovisual work and the authors of contributions as well as relations between co-authors themselves are regulated by the contract of film production.</p> <p>2. With the contract of film producer, the authors of audiovisual work and the authors of contribution undertake the obligation toward film producer to cooperate in a innovative way in creating the audiovisual work and assign all the property rights related to that work, whereas the film producer takes over the obligation to pay remuneration to the author.</p> <p>3. By entering into a contract for the film production, it shall be presumed that the coauthors and the authors of contributions exclusively and without limitations, have assigned to the film producer all property rights and other rights of audiovisual work, its translations in other languages and other</p>	<p>1. Međusobni odnosi filmskog producenta sa autorima audiovizuelnog dela i autorima doprinosa, kao i odnosi među samim ko-autorima, regulišu se putem ugovora za filmsku proizvodnju.</p> <p>2. Ugovorom o filmskoj proizvodnji, autori audiovizuelnog dela i autori doprinosa, preuzimaju obavezu o stvaralačkoj saradnji prema filmskom producentu, u stvaranju audiovizuelnog dela i, prenose mu sva svoja imovinska prava nad delom, dok će filmski producent preuzeti obavezu da autoru isplati kompenzaciju.</p> <p>3. Sklapanjem ugovora o filmskoj proizvodnji, smatra se da, ko-autori i autori doprinosa, na ekskluzivan način i bez ograničenja, prenose na filmskog producenta sva imovinska prava i ostala autorska prava nad audiovizuelnim delom, njegovih prevoda u drugim jezicima i</p>



<p>gjuhë të tjera dhe përpunimet tjera audiovizuele si dhe fotografitë që kanë të bëjnë me veprën, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.</p> <p>4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni:</p> <p>4.1. Bashkautorët ruajnë të drejtën ekskluzive deri në përpunimin e mëtejshëm të veprës audiovizuele në një formë tjetër artistike;</p> <p>4.2. Autorët e kontributeve e ruajnë të Drejtën ekskluzive që kontributet e tyre në veprën audiovizuele, pas përfundimit të veprës, t'i shfrytëzojnë ndaras nga vepra audiovizuele, nëse me këtë nuk do të shkelen të drejtat e producentit të filmit;</p> <p>4.3. Bashkautorët dhe autorët e Kontributeve ruajnë të drejtën e Kompensimit përkatës nga Producenti i filmit, për çdo qiradhënie të videogramave të veprës audiovizuele.</p> <p>5. Bashkautorët dhe autorët e kontributeve nuk mund të heqin dorë nga të drejtat sipas paragrafit 4 të këtij neni.</p>	<p>audiovisual processings as well as photography related to the work, if not otherwise provided by this contract.</p> <p>4. Regardless the provisions of paragraph 3 of this article:</p> <p>4.1. Co-authors retain the exclusive right until the further processing of audiovisual work in another artistic mode;</p> <p>4.2. The authors of contributions retain the exclusive right that their contributions in audiovisual work after the completion of work are used separately from the audiovisual work, if by that the rights of film producer are not infringed;</p> <p>4.3. Co-authors and authors of Contributions retain the right of relevant compensation from the film producer, for every leasing of videograms of audiovisual work.</p> <p>5. Co-authors and authors of contributions can not resign from the rights referred to in paragraph 4 of this article.</p>	<p>ostale audiovizuelne prerade, kao i fotografije koje se tiču dela, ako se ugovorom nije drugačije predvidelo.</p> <p>4. Nezavisno od dispozicija paragrafa 3 ovog člana:</p> <p>4.1. Ko-autori zadržavaju ekskluzivno pravo do dalje obrade audiovizuelnog dela, u neki drugi oblik;</p> <p>4.2. Autori doprinosa zadržavaju Ekskluzivno pravo da, njihove doprinose u audiovizuelnom delu, nakon završavanja dela, iz audiovizuelnog dela, odvojeno koriste, ako se time neće prekršiti prava filmskog producenta;</p> <p>4.3. Ko-autori i autori doprinosa, zadržavaju pravo na određenu kompenzaciju od filmskog producenta, za svako davanje videograma audiovizuelnog dela pod zakup.</p> <p>5. Ko-autori i autori doprinosa se ne mogu odreći prava prema paragrafu 4 ovog člana.</p>
--	--	--



<p style="text-align: center;">Neni 114 Kompensimi i autorit</p> <p>1. Bashkautorëve të veprës audiovizuele u takon kompensimi i autorit ndaras për secilën të drejtë pasurore, apo të drejtë tjetër të autorit që ia kanë kaluar producentit të filmit.</p> <p>2. Producenti i filmit detyrohet që, të paktën një herë në vit, t'i informojë bashkautorët e veprës audiovizuele lidhur me të ardhurat e realizuara për secilën formë të autorizuar të shfrytëzimit të veprës, si dhe t'u mundësojë të njihen me të dhënat që u referohen të ardhurave.</p>	<p style="text-align: center;">Article 114 Remuneration of the author</p> <p>1. The remuneration of the author belongs to co-authors of an audiovisual work, separately for each property right, or other authors' right assigned to the movie producer.</p> <p>2. The movie producer is obliged at least once a year to inform the co-authors of the audiovisual work on executed incomings for each authorized form of use of the work, and to enable them to see the data referring to the incomings.</p>	<p style="text-align: center;">Član 114 Kompenzacija autora</p> <p>1. Ko-autorima audiovizuelnog dela pripada kompenzacija autora, odvojeno, za svako imovinsko pravo, ili neko drugo autorsko pravo koje su preneli filmskom producentu.</p> <p>2. Filmski producent se obavezuje da, najmanje jednom godišnje, informiše ko-autore audiovizuelnog dela u vezi realizovanih prihoda, za svaki oblik ovlašćenja o korišćenju dela, kao i da im omogući da se upoznaju o podacima koja se referišu prihodima.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 115 Përfundimi i veprës audiovizuele</p> <p>1. Vepra audiovizuele konsiderohet e përfunduar kur mes regjisorit kryesor dhe producentit të filmit arrihet pëlqimi se kopja e parë standarde është e përfunduar.</p> <p>2. Çfarëdo ndryshimi i kopjes së parë standarde nga paragrafi 1 i këtij neni nuk lejohet të bëhet pa pëlqimin e arritur ndërmjet regjisorit kryesor dhe producentit të filmit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 115 Completion of the audiovisual work</p> <p>1. The audiovisual work is considered as completed when a consent is reached between the main director and film producer that the first standard copy is completed.</p> <p>2. Any alteration of the first standard copy from paragraph 1 of this article is not allowed to be carried out without the reached consent between the main director and the film producer.</p>	<p style="text-align: center;">Član 115 Završavanje audiovizuelnog dela</p> <p>1. Audiovizuelno delo se smatra završenim, kada se između glavnog režisera i filmskog producenta postigne saglasnost, da je prva standardna kopija završena.</p> <p>2. Bilo koja promena prve standardne kopije, iz paragrafa 1 ovog člana, ne dozvoljava se da se izvrši, bez postignutog dogovora između režisera i filmskog producenta.</p>



<p>3. Nuk lejohet shkatërrimi i kopjes së parë standarde të veprës audiovizuele.</p> <p>4. Po qe se një nga bashkautorët apo autorët e kontributeve nuk dëshiron përfundimin e plotë të kontributit të vet në veprën audiovizuale ose kur nuk ka mundësi për të vazhduar bashkëpunimin nuk mund ta kundërshtojë shfrytëzimin e kontributit të tij të deriatëhershëm për qëllim të përfundimit të plotë të veprës. Në rast të këtillë autori gëzon të drejtat lidhur me kontributin e tij të deriatëhershëm.</p>	<p>3. Extermination of the first standard copy of the audiovisual work is not permitted.</p> <p>4. If one of the co-authors or contributive authors does not want the full completion of his contribution on the audiovisual work or does not have the possibility to continue the cooperation, he cannot oppose the use of his so far contribution for the purpose of the work. In this case, the author enjoys the rights on his so far contribution.</p>	<p>3. Ne dozvoljava se uništavanje prve standardne kopije audiovizuelnog dela.</p> <p>4. Ako jedan od ko-autora ili autora doprinosa, ne želi potpuno završavanje svog doprinosa u audiovizuelom delu, ili kada nema mogućnosti da se saradnja nastavi, ne mogu suprostaviti korišćenje svojih dotadašnjih doprinosa, u cilju potpunog završavanja dela. U tom slučaju, autor uživa prava u vezi njegovog dotadašnjeg doprinosa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 116 Zgjidhja e kontratës</p> <p>1. Nëse producenti i filmit nuk ka arritur ta përfundojë veprën audiovizuale për tri vite, që nga dita e lidhjes së kontratës për veprën filmike, bashkautorët kanë të drejtë të zgjidhin kontratën, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.</p> <p>2. Përveç të drejtës për zgjidhjen e kontratës, bashkautorët e veprës audiovizuale kanë të drejtë në dëmshpërblim, nëse producenti i filmit nuk fillon shfrytëzimin e veprës së përfunduar audiovizuale brenda një viti që nga dita e</p>	<p style="text-align: center;">Article 116 Annuling of the Contract</p> <p>1.If the film producer does not manage to complete the audiovisual work for three years from the day of entering into the contract for the film work, the co-authors have the right to annul the contract, unless otherwise provided by the contract.</p> <p>2. Besides the right to annul the contract, co-authors of the audiovisual work have the right to indemnity, if the film producer does not start to use the completed audiovisual work within a year from the day of the completion if its first standard</p>	<p style="text-align: center;">Član 116 Raskid ugovora</p> <p>1. Ako filmski producent nije uspeo da završi audiovizuelno delo za tri godine, od dana sklapanja ugovora za filmsko delo, ko-autori imaju pravo da raskinu ugovor, ako se ugovorom drugačije ne predviđa.</p> <p>2. Osim prava na raskid ugovora, ko-autori audiovizuelnog dela, imaju pravo na odštetu, ako filmski producent ne počne sa korišćenjem završenog audiovizuelnog dela, u toku godine dana, od dana završavanja prve standardne kopije, ako se</p>



<p>përfundimit të kopjes së parë standarde, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.</p> <p>3. Në rastet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, bashkautorët dhe autorët e kontributeve mbajnë të drejtën e pagesës së kompensimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 117 Të drejtat mbi fotografitë</p> <p>Me lidhjen e kontratës për prodhimin e filmit konsiderohet se drejtori i fotografisë ia ka kaluar producentit të filmit të gjitha të drejtat e shfrytëzimit të fotografive që janë bërë gjatë prodhimit të veprës audiovizuele.</p> <p style="text-align: center;">Neni 118 Kufizimi i të drejtave</p> <p>Autori i veprës burimore, i cili ka kaluar të drejtën për përshtatje audiovizuele, si dhe bashkautorët e veprës audiovizuele dhe autorët e kontributeve në veprën audiovizuele nuk gëzojnë të drejtën e pendimit neni 20 si dhe të drejtën e revokimit të të drejtave ekonomike neni 87.</p>	<p>copy, unless otherwise provided by the contract.</p> <p>3. In cases of paragraph 1 and 2 of this article, the co-authors and authors of the contributions hold the right of remuneration.</p> <p style="text-align: center;">Article 117 Rights on photographs</p> <p>When entering into a contract for the movie production, it is considered that the director of photography has assigned to the film producer all the rights to use the photographs taken during the production of the audiovisual work.</p> <p style="text-align: center;">Article 118 Limitation of the rights</p> <p>Author of the source work, who has assigned his right for audiovisual adaption, and the co-authors of the audiovisual work, and the authors of the contribution on the audiovisual work do not enjoy the right of remorse referred to in article 20, and the right of revocation of the economical rights referred to in article 87.</p>	<p>ugovorom drugačije ne predviđa.</p> <p>3. U slučajevima iz paragrafa 1 i 2 ovog člana, ko-autori i autori doprinosa zadržavaju pravo na isplatu kompenzacije</p> <p style="text-align: center;">Član 117 Prava nad fotografijom</p> <p>U sklapanju ugovora za filmsku proizvodnju, smatra se da je direktor fotografije, preneo na filmskog producenta, sva prava za korišćenje fotografija, koje su napravljene tokom proizvodnje audiovizuelnog dela.</p> <p style="text-align: center;">Član 118 Ograničavanje prava</p> <p>Autor izvornog dela, koji je preneo pravo na audiovizuelnu adaptaciju, kao i ko-autori audiovizuelnog dela i autori doprinosa u audiovizuelnom delu, ne uživaju pravo na kajanje, član 20 i pravo na opoziv ekonomskih prava, član 87.</p>
---	---	--



<p style="text-align: center;">Neni 119 Programet kompjuterike</p> <p>Nuk gëzojnë mbrojtje idetë dhe parimet që përbëjnë bazën e cilitdo element të programit, duke përfshirë edhe ato që përbëjnë bazën e ndërfaqes.</p>	<p style="text-align: center;">Article 119 Computer Programmes</p> <p>The ideas and principles constituting the base of any element of the program shall not enjoy protection, including those that constitute the base of the interface.</p>	<p style="text-align: center;">Član 119 Kompjuterski programi</p> <p>Ne uživaju zaštitu ideje i načela koja sadrže bazu bilo kog programskog elementa, obuhvatajući i one, koji sadrže osnov među stranicama.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 120</p> <p>Nëse autori ka bërë program kompjuterik duke përmbushur detyrat e tij të punës ose sipas udhëzimeve të punëdhënësit të tij, përkatësisht nëse autori ka bërë program kompjuterik në bazë të kontratës për porosi të veprës, konsiderohet se të gjitha të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit mbi atë program kompjuteri i janë kaluar ekskluzivisht dhe pa kufizime punëdhënësit, përkatësisht porositësit të programit, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.</p>	<p style="text-align: center;">Article 120</p> <p>If the author has created a computer program while fulfilling his duties or according to the instruction by his employer, respectively if the author has created a computer program based on the contract for request of work, it is considered that all authors' property rights and other authors; rights on that computer program were assigned exclusively and without limitations to the employer, respectively to the one requesting the program, unless otherwise provided by this contract.</p>	<p style="text-align: center;">Član 120</p> <p>Ako je autor napravio kompjuterski program, ispunjavajući svoje radne zadatke, ili prema uputstvima svog poslodavca, odnosno ako je autor napravio kompjuterski program, na osnovu ugovora o naručivanju dela, smatra se da su se sva imovinska prava, i ostala autorska prava nad tim kompjuterskim programom, ekskluzivno i bez ograničenja prenela na poslodavca, odnosno naručioca programa, ako se ugovorom drugačije ne predviđa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 121 Të drejtat e autorit</p> <p>1. Autori i programit kompjuterik ka të drejtë ekskluzive të lejojë apo të ndalojë, në veçanti:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Riprodhimin e pjesëve përbërëse</p>	<p style="text-align: center;">Article 121 Copyright</p> <p>1. The author of the computer program has the exclusive right to authorize or prohibit, especially:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Reproduction of the consisting parts</p>	<p style="text-align: center;">Član 121 Autorska prava</p> <p>1. Autor kompjuterskog programa, ima ekskluzivno pravo da dozvoli ili zabrani, posebno:</p> <p style="padding-left: 20px;">1.1. Reprodukciju sastavnih delova ili</p>



<p>apo të programit kompjuterik në tërësi, me çfarëdo mjeti apo në çfarëdo forme, pa marrë parasysh a është i përkohshëm apo përhershëm. Në rast se vendosja, ekspozimi, vënia në punë, transmetimi ose deponimi i programit kërkon riprodhimin e tij, për të kryer këto veprime duhet patjetër leja e autorit;</p> <p>1.2. Përkthimin, përshtatjen, rregullimin ose ndonjë përpunim tjetër të programit kompjuterik, si dhe riprodhimin e rezultateve të ndryshimeve të tilla, por pa prekur të drejtat e personit i cili ka bërë ato ndryshime;</p> <p>1.3. Shpërndarjen e origjinalit të Programit kompjuterik ose të Ekzemplarëve të tij në çfarëdo forme, duke përfshirë edhe qiradhënien.</p> <p>1.4. Autori mundet, gjithashtu, të kalojë të drejtat nga nënparagrafi 1.3 i këtij neni në personat e tretë edhe me kontratë për dhënien e licencës.</p>	<p>or of the computer program in its entirety, through any means or form, regardless if it is temporary or permanent.</p> <p>In case of the placement, exposure, operationalising, transmission or deposition of the program requires its reproduction to conduct these activities, the author's permission is a must;</p> <p>1.2. Translation, adaption, adjustment or any other processing of the computer program, and the reproduction of such alterations, but without affecting the rights of the person who made those alterations;</p> <p>1.3. Distributions of the original computer program or of its copies in any form, including its lease.</p> <p>1.4. The author may also assign the rights from subparagraph 1.3 of this article to the third persons with contract for issue of permission.</p>	<p>kompjuterskog programa u celini, bilo kojim sredstvom ili u bilo kakvom obliku, bez obzira da li je privremeni ili stalni. U slučaju da postavljanje, izlaganje, uključivanje, prenos ili deponovanje programa, zahteva njegovu reprodukciju da bi se izvršile ove delatnosti, neminovno je potrebna dozvola autora;</p> <p>1.2. Prevod, adaptaciju, regulisanje ili neku drugu obradu kompjuterskog Programa, kao i reprodukciju rezultata takvih promena, ali, ne dotičući prava osobe koja je te promene izvršila;</p> <p>1.3. Raspodelu originala kompjuterskog programa ili njenih primeraka, u bilo kom obliku, obuhvatajući i davanje pod zakup.</p> <p>1.4. Autor može takođe da prenese prava iz podparagrafa 1.3 ovog člana, trećim licima i ugovorom o davanju licence.</p>
--	--	---



Neni 122 Kufizimet e të drejtave të autorit	Article 122 Limitations of author's rights	Član 122 Ograničenja autorski prava
<p>1. Nëse me kontratë nuk përcaktohet ndryshe, zotëruesi i ligjshëm i programit kompjuterik pa autorizimin e autorit mund t'i kryejë veprimet sipas nënparagrafeve 1.1 dhe 1.2, të paragrafit 1 të nenit 122 të këtij Ligji, duke përfshirë edhe korigjimin e gabimeve, por në masën që është e domosdoshme për shfrytëzimin e programit kompjuterik në përputhje me qëllimin e tij.</p> <p>2. Personi që gëzon të drejtën për të shfrytëzuar programin kompjuterik, pa autorizimin e autorit, mund të bëjë një kopje rezervë të programit kompjuterik, nëse kjo është e nevojshme për shfrytëzimin e tij.</p> <p>3. Personi që gëzon të drejtën për të shfrytëzuar kopjen e programit kompjuterik, pa autorizimin e autorit, mund të vëzhgojë, studiojë ose të provojë funksionimin e programit kompjuterik, për të forcuar idetë dhe parimet që janë themel i cilitdo element të programit kompjuterik, nëse këtë e bën gjatë veprimit të vendosjes, ekspozimit, vënies në punë, transmetimit ose deponimit të programit për të cilin ka autorizim.</p>	<p>1. Unless otherwise provided by the contract, the legal owner of the computer program, can carry out the activities under subparagraphs 1.1 and 1.2, and paragraphs 1 of article 122 of this law without the authorization from the author, including the review of mistakes, but at the required measure which is necessary to the use of the computer program, in compliance with its purpose.</p> <p>2. The person who enjoys the right to use the computer program may without the authorization of the author, make a back-up copy, provided this is necessary for its use.</p> <p>3. The person having the right to use a copy of the computer program shall be entitled, without the authorization by the author, to observe, study or test the functioning of a program in order to determine the ideas and principles that underlie any element of the program, if he does so while performing any act of loading, displaying, running, transmitting or storing the program which he is authorized for.</p>	<p>1. Ako se ugovorom drugačije ne odredi, zakonski vlasnik kompjuterskog programa, bez autorskog ovlašćenja, može vršiti delatnosti prema podparagrafima 1.1 i 1.2, paragrafu 1 člana 122 ovog zakona, obuhvatajući i korigovanje grešaka ali, u meri koja je neophodna za korišćenje kompjuterskog programa u podudarnosti njegove svrhe.</p> <p>2. Osoba koja uživa pravo na korišćenje kompjuterskog programa, bez autorskog ovlašćenja, može napraviti jednu rezervnu kopiju kompjuterskog programa, ako je to potrebno, za njegovo korišćenje.</p> <p>3. Osoba koja uživa pravo na korišćenje kopije kompjuterskog programa, bez autorskog ovlašćenja može posmatrati, studirati ili probati funkcionisanje kompjuterskog programa, da bi ojačao ideje i načela, koja su osnov bilo kog elementa kompjuterskog programa, ako to čini tokom delatnosti postavljanja, izlaganja, uključivanja, prenosa ili deponovanja programa, za koji ima ovlašćenje.</p>



<p>4. Ndaj programeve kompjuterike nuk zbatohen dispozitat lidhur me të drejtën e pendimit sipas nenit 20, të drejtën e kompensimit të veçantë sipas nenit 38 dhe të drejtën për riprodhim privat ose tjetër vetanak sipas neni 44.</p> <p>5. Përcaktimet kontraktore që janë në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni janë të pavlefshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 123 Zbërthimi</p> <p>1. Nuk është e domosdoshme leja e autorit, në kuptim të pikave 1.1 dhe 1.2 paragrafi 1 të nenit 122 të këtij Ligji, për të bërë riprodhimin e kodit apo përkthimin e formave të tij, kur riprodhimi apo përkthimi i tillë është i domosdoshëm për të nxjerrë të dhënat për arritjen e ndërveprimit të programit kompjuterik të krijuar në mënyrë të pavarur, me programet tjera ose mekanizmin e kompjuterit, nëse plotësohen kushtet në vijim:</p> <p>1.1. Që këto veprime të bëhen nga zotëruesi i licencës ose shfrytëzuesi tjetër i autorizuar ose në emër të tyre, nga një person tjetër;</p>	<p>4. Provisions on the right of remorse according to article 20, the right to special remuneration according to article 38 and the right to private or other internal reproduction according to article 44 shall not apply to computer programs.</p> <p>5. Contractual stipulations contrary to the provisions from paragraph 2 and 3 of this article are null.</p> <p style="text-align: center;">Article 123 Diffraction</p> <p>1. The permission of the author is not necessary for the purpose of article 1.1 and 1.2, paragraph 1 of article 122 of this law, on reproduction of the code or translation of its forms, when such reproduction or translation is necessary to extract the data on achieving the interaction of the created computer program with other programs or computer mechanisms, if the following conditions are met:</p> <p>1.1. These activities to be carried out by the owner of the permit or other authorized user, or by another persons on their behalf ;</p>	<p>4. Prema kompjuterskim programina, ne sprovode se dispozicije u vezi prava kajanja prema članu 20, prava na posebnu kompenzaciju prema članu 38 i prava na privatnu reprodukciju ili neku drugu ličnu potrebu, prema članu 44.</p> <p>5. Ugovaračka određivanja koja su u suprotnosti sa dispozicijama iz paragrafa 2 i 3 ovog člana su bezvredna.</p> <p style="text-align: center;">Član 123 Razlaganje</p> <p>1. Nije neophodna dozvola autora, u smislu tačaka 1.1 i 1.2 paragrafa 1 člana 122 ovog zakona, da se izvrši reprodukcija koda ili, prevoda njenih oblika, kada su takva reprodukcija ili prevod neophodni, da bi se izvadili podaci o dostignuću međudelatnosti kompjuterskog programa, stvorenog na nezavisan način, sa drugim programmima ili mehanizmima kompjutera, ako se ispune sledeći uslovi:</p> <p>1.1. Da se te delatnosti vrše od vlasnika Licence ili drugog ovlašćenog korisnika ili, u njihovo ime, od neke druge osobe;</p>
---	--	--



<p>1.2. Që informacioni i nevojshëm për ndërveprim nuk ka qenë më parë i kapshëm në mënyrë të lehtë për personat nga pika 1.1 paragrafi 1 të këtij neni;</p> <p>1.3. Që këto veprime të kufizohen vetëm në ato pjesë të programit ekzistues që janë të domosdoshme për arritjen e ndërveprimit.</p> <p>2. Është e ndaluar që informacionet e nxjerra me veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni:</p> <p>2.1. Të përdoren për qëllime të tjera, përveç për arritjen e ndërveprimit të programit kompjuterik të krijuar në mënyrë të pavarur;</p> <p>2.2. T'u jepen personave të tjerë, përveç kur kjo është e domosdoshme për arritjen e ndërveprimit të programit kompjuterik të krijuar në mënyrë të pavarur;</p> <p>2.3. Të përdoren për krijimin, prodhimin ose nxjerrjen në treg të programit tjetër kompjuterik, i cili për nga shprehja e tij është thelbësisht i ngjashëm, ose për çfarëdo veprimi</p>	<p>1.2. That the required information for the interaction was previously easily accessible to the persons from point 1.1, paragraph 1 of this article;</p> <p>1.3. That these activities are limited only on those parts of the existing program which are required for achieving the interaction.</p> <p>2. It is prohibited that extracted information from activities of paragraph 1 of this article:</p> <p>2.1. Are used for other purposes, other than for achieving the interaction of the independently created computer program;</p> <p>2.2. Are passed on to other persons, other than when this is necessary for achieving the interaction of the independently created computer program;</p> <p>2.3. Are used for creating, production or launch in the market of the other computer program, expression of which is essentially similar, or for any activity by which the author's</p>	<p>1.2. Da potrebna informacija za rad na njemu, ranije nije bila lako razumljiva za osobe iz tačke 1.1 paragrafa 1 ovog člana;</p> <p>1.3. Da se te delatnosti ograniče samo na onim delovima postojećeg programa, koja su neophodna za postizanje rada na njemu.</p> <p>2. Zabranjeno je da uzete informacije sa delatnostima iz paragrafa 1 ovog člana:</p> <p>2.1. Da se koriste u druge svrhe, osim postizanje rada na kompjuterskim programima, stvorenih na nezavisan način;</p> <p>2.2. Da se daju drugim osobama, osim kada je to neophodno za postizanje rada na kompjuterskom programu, stvorenog na nezavisan način;</p> <p>2.3. Da se koriste za stvaranje, proizvodnju ili iznošenje na tržište drugog kompjuterskog programa, koji je svojim izgledom suštinski sličan, ili</p>
---	---	--



<p>me të cilin shkelet e drejta e autorit.</p> <p>3. Dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të interpretohen në atë mënyrë që do të lejojë zbatimin e tyre në kundërshtim me përdorimin normal të programit kompjuterik ose duke cënuar të drejtat e ligjshme të autorit.</p> <p>4. Përcaktimet kontraktore që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij neni janë të pavlefshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 124 Masat e veçanta të mbrojtjes</p> <p>1. Cënim i të drejtës së autorit mbi programin kompjuterik konsiderohet:</p> <p>1.1. Çdo shpërndarje, duke përfshirë edhe ofertën për shfrytëzimin e një a më shumë ekzemplarëve të programit kompjuterik, për të cilin dihet ose do të mund të dihej se është ekzemplar i paligjshëm.</p> <p>1.2. Zotërimi për qëllime komerciale i ekzemplarit të programit kompjuterik, për të cilin dihet ose do të mund të dihej se është ekzemplar i paligjshëm.</p>	<p>right is violated.</p> <p>3. Provision from paragraph 1 of this article can not be interpreted in a way which would allow its implementation in contrary with the normal use of the computer program, or violating the legal rights of the author.</p> <p>4. Contractual stipulations contrary to the provisions from paragraph 2 and 3 of this article are null.</p> <p style="text-align: center;">Article 124 Special protection measures</p> <p>1. Violation of the author's right on the computer program is considered:</p> <p>1.1. Any distribution, including also the offer for the use of one or more copies of the computer program, which is known that it is or it could be an illegal copy.</p> <p>1.2. Possession of the copy of the computer program for commercial use, which is known that it is or it could be an illegal copy.</p>	<p>zbog bilo koje delatnosti, kojim se krši autorsko pravo.</p> <p>3. Dispozicije iz paragrafa 1 ovog člana, ne mogu se interpretirati na način kojim bi se dozvolilo njihovo sprovođenje, u suprotnosti normalnog korišćenja kompjuterskog programa, povređujući zakonska autorska prava.</p> <p>4. Ugovaračka određivanja koja su u suprotnosti sa dispozicijama ovog člana su bezvredna.</p> <p style="text-align: center;">Član 124 Posebne mere zaštite</p> <p>1. Povredivost autorskog prava nad kompjuterskim programom smatra se:</p> <p>1.1. Svaka raspodela, obuhvatajući i ponudu o korišćenju jednog ili više primeraka kompjuterskog programa, za koji se zna da se može saznati da je nezakonit primerak.</p> <p>1.2. Vlasništvo u komercialne svrhe primerka kompjuterskog programa, za koji se zna ili se može saznati da je nezakonit primerak.</p>
--	---	--



Neni 125 Zbatimi i dispozitave të tjera ligjore	Article 125 Application of other legal provisions	Član 125 Sprovođenje ostali zakonskih dispozicija
<p>Dispozitat e këtij Ligji lidhur me programet kompjuterike nuk prekin dispozitat tjera ligjore lidhur me programet kompjuterike, siç janë ato për patentën, markën e prodhimit, mbrojtjen e gjysmëpërçuesve, mbrojtjen nga konkurrenca jolojale, sekretin zyrtar, si dhe të drejtës së detyrimeve.</p>	<p>Provisions of this law on computer programs do not affect other legal provisions on computer programs, such as license, production brand, protection of semiconductors, protection from non loyal competition, official secret and the right of obligations.</p>	<p>Dispozicija ovog zakona u vezi kompjuterskih programa ne dotiču ostale zakonske dispozicije, u vezi kompjuterskih programa, kao što su ona za patente, marke za proizvodnju, zaštite poluodašiljača, zaštite od nelojalne konkurencije, službene tajnosti kao i prava na obavezu.</p>
Neni 126 Vepra e autorit nga marrdhënia e punës	Article 126 Author's work from working relationship	Član 126 Autorsko delo iz radnog odnosa
<p>1. Kur vepra e autorit krijohet nga i punësuar i gjatë marrëdhënies së punës, duke përmbushur detyrat e veta të punës ose sipas udhëzimeve të punëdhënësit, konsiderohet se të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit i janë kaluar ekskluzivisht dhe pakufizime punëdhënësit, për një periudhë dhjetëvjeçare që nga përfundimi i veprës, nëse me kontratën e punësimit apo me një akt tjetër të shkruar me punëdhënësin nuk është parashikuar ndryshe.</p>	<p>1. When the author's work is created from the employee during his working relationship, while fulfilling his work duties or according to the instructions given by the employer, its is considered that the property rights and other author's rights were assigned exclusively and without limitations to the employer, for a period of ten years, from the completion of the work, unless otherwise provided by the employment contract or by another signed act with the employer.</p>	<p>1. Kada se autorsko delo stvori od zapošljenog tokom radnog odnosa, ispunjavajući svoje radne obaveze ili obaveze prema uputstvima poslodavca, smatra se da su imovinska prava i ostala autorska prava, ekskluzivno i bez ograničenja, prenesena na poslodavca, za jedan desetogodišnji period od završavanja dela, ako se poslovnim ugovorom ili nekim drugim pisanim aktom sa poslodavcem, nije drugačije predviđeno.</p>
<p>2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1</p>	<p>2. Regardless of the provisions referred to</p>	<p>2. Nezavisno od dispozicija paragrafa 1</p>



<p>të këtij neni, të drejtat do t'i kthehen autorit të punësuar para mbarimit të afatit të tillë, në rast të vdekjes së punëdhënësit, përkatësisht në rast të likuidimit të punëdhënësit si person juridik.</p> <p>3. Nëse punëdhënësi fare nuk i shfrytëzon të drejtat pasurore mbi atë vepër, ose i shfrytëzon në masë të papërfillshme, autori i punësuar ka të drejtë të kërkojë nga punëdhënësi që ky t'ia kalojë ato të drejta kundrejt kompensimit të shpenzimeve.</p> <p>4. Nëse nuk është kontraktuar ndryshe në mes autorit dhe punëdhënësit, i punësuar si autor i veprës gëzon të drejtën të kërkojë nga punëdhënësi kompensim shtesë, nëse paga e tij është në shpërpjesëtim të dukshëm me fitimet apo kursimet e realizuara në saje të shfrytëzimit të veprës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 127</p> <p>Pavarësisht nga dispozitat e nenit 127 të këtij Ligji, autori i veprës ruan të drejtën ekskluzive për të përfshirë veprën e vet në koleksion të veprave të zgjedhura të tij ose në koleksion të të gjitha veprave të tij.</p>	<p>in paragraph 1 of this article, the rights will be returned to the employed author before the completion of such term, in case of employer's death, respectively in case of employer's liquidation as a legal person.</p> <p>3. If the employer does not use the property rights on that work, or uses them in a negligible manner, the employed author has the right to ask from the employer to assign those rights to him, against compensation of expenses.</p> <p>4. Unless otherwise contracted between the author and employer, the employee, as the author of the work enjoys the right to claim additional compensation from the employer, if his salary evident disproportion with the incomings and savings realized due to the use of the work.</p> <p style="text-align: center;">Article 127</p> <p>Regardless of the provisions of article 127 of this law, the author of the work holds the exclusive right to include his work on the collection of his selected works or on a collection of all his works.</p>	<p>ovog člana, prava će se vratiti zaposlenom autoru, pre isteka tog roka, u slučaju smrti poslodavca, odnosno u slučaju likvidacije poslodavca, kao pravnog lica.</p> <p>3. Ako poslodavac uopšte ne iskoristi imovinska prava nad tim delom, ili ih iskoristi u neznatnoj meri, zaposleni autor ima prava da zahteva od poslodavca, da mu ovaj prenese ta prava, srazmerno kompenzaciji troškova.</p> <p>4. Ako nije drugačije ugovoreno između autora i poslodavca, zaposleni, kao autor dela, uživa pravo da traži od poslodavca dodatnu kompenzaciju, ako je njegova plata u vidnoj disproporciji sa zaradama ili realizovanim uštedama na osnovu korišćenja dela</p> <p style="text-align: center;">Član 127</p> <p>Nezavisno od dispozicija člana 127 ovog zakona, autor dela ima ekskluzivno pravo da uključi svoje delo u kolekciju svojih izabranih dela ili u kolekciju svih njegovih dela.</p>
--	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 128</p> <p>Të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit që kanë të bëjnë me bazën e të dhënave ose me veprën kolektive të krijuar gjatë marrëdhënies së punës konsiderohen se i janë kaluar punëdhënësit ekskluzivisht dhe pa kufizime, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe</p>	<p style="text-align: center;">Article 128</p> <p>Property rights and other rights of the author related to the data base or with the collective work created during the working relationship, it is considered that they were assigned to the employer exclusively and without limitations, unless otherwise provided by the contract.</p>	<p style="text-align: center;">Član 128</p> <p>Imovinska i ostala prava autora koja se tiču osnove podataka ili kolektivnog dela stvorenih tokom radnog odnosa, smatraće se da su prebačena poslodavcu ekskluzivno i bez ograničenja, ukoliko se ugovorom drugačije ne predviđa.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 129 Veprat e krijuara gjatë shkollimit</p> <p>Institucionet arsimore kanë të drejtë që vepra të plota të autorëve ose pjesë të veprave të nxënësve apo studentëve të vet t'i përfshijnë në koleksione veprash shkollore të nxënësve apo studentëve të vet, si dhe këto koleksione t'i reprodukojnë dhe shpërndajnë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 129 Works created during the education</p> <p>Educational institutions have the right to include on their school collection of works and to reproduce, full works of authors or parts of the pupils and their student's works, and to also reproduce and distribute these collections.</p>	<p style="text-align: center;">Član 129 Stvorena dela tokom školovanja</p> <p>Obrazovne institucije imaju pravo da potpuna dela ili dela učenika ili svojih studenata uključuju u kolekcije školskih dela svojih učenika ili studenata, kao i da ove kolekcije reprodukuju raspodeljuju.</p>
<p style="text-align: center;">KREU II</p> <p style="text-align: center;">TË DREJTAT E PËRAFËRTA</p> <p style="text-align: center;">Nënkreu A</p> <p style="text-align: center;">TË DREJTAT E INTERPRETUESVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 130 Të drejtat morale të interpretuesve</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER II</p> <p style="text-align: center;">RELATED RIGHTS</p> <p style="text-align: center;">Sub-chapter A</p> <p style="text-align: center;">PERFORMERS RIGHTS</p> <p style="text-align: center;">Article 130 Moral rights of performers</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE II</p> <p style="text-align: center;">PRIBLIŽNA PRAVA</p> <p style="text-align: center;">Poglavlje A</p> <p style="text-align: center;">PRAVA IZVOĐAČA</p> <p style="text-align: center;">Član 130 Moralna prava izvođača</p>



<p>1. Interpretuesit kanë të drejtë ekskluzive:</p> <p>1.1. Që emri, pseudonimi apo shenja e tyre të tregohet me rastin e shfrytëzimit të interpretimit të tyre;</p> <p>1.2. Të kundërshtojnë çdo deformim, shëmtim apo shfrytëzim të interpretimit që mund të çënojë nderin dhe namnin e tyre.</p> <p>2. Nëse interpretimin e bën ansambli i interpretuesve të drejtën nga pika 1.1 e paragrafi 1 e mban ansambli si tërësi, solistët dhe udhëheqësi artistik.</p> <p>3. Me rastin e vlerësimit nëse me një formë konkrete të shfrytëzimit çënohen nderi dhe respekti i interpretuesit merret parasysh masa e arsyeshme e ndjeshmërisë së interpretuesit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 131 Të drejtat pasurore të interpretuesve</p> <p>1. Interpretuesi ka të drejtë të lejojë apo të ndalojë:</p> <p>1.1. Fiksimit e interpretimit të tij drejtpërdrejt;</p>	<p>1. The performers have the exclusive right:</p> <p>1.1. Their name, alias or mark to be shown when used for their performance;</p> <p>1.2. To oppose any disfiguration, deformity or use of the performance, which would, hurt their honor and fame.</p> <p>2. If the performance is done by the ensemble of performers, the right from point 1.1 of paragraph 1 holds the ensemble as a whole, solists and the artistic leader.</p> <p>3. When assessing whether by one concrete form of use, performers honor and respect are hurt, reasonable measure of performer's sensitivity is considered.</p> <p style="text-align: center;">Article 131 Property rights of the performers</p> <p>1. The performer has the right to allow or prohibit:</p> <p>1.1 Fixation of his direct performance;</p>	<p>1. Izvođači imaju ekskluzivno pravo:</p> <p>1.1. Da se njihovo ime, pseudonim ili znak prikažu prilikom korišćenja njihovog interpretiranja;</p> <p>1.2. Suprotstavljati se svakoj deformaciji, unakaženju ili korišćenju interpretiranja, koja mogu povrediti njihovu čast i popularnost.</p> <p>2. Ukoliko interpretiranje vrši ansambl izvođača, pravo iz tačke 1.1 i paragrafa 1 zadržaće ansambl kao celina, solisti i umetnički rukovodilac.</p> <p>3. Tokom vrednovanja, ako se u nekom obliku korišćenja, povredi čast i poštovanje izvođača, uzeće se u obzir opravdana mera osetljivosti izvođača.</p> <p style="text-align: center;">Član 131 Imovinska prava izvođača</p> <p>1. Izvođač ima pravo da odobri ili zabrani:</p> <p>1.1 Fiksiranje njegovog direktnog interpretiranja;</p>
--	---	---



<p>1.2.Riprodhimin e interpretimit të tij në fonograme dhe videograme;</p> <p>1.3.Shpërndarjen e fonogrameve dhe të Videogrameve që përmbajnë interpretimin e tij;</p> <p>1.4.Qiradhënien e fonogramit ose të videogramit që përmban interpretimin e tij;</p> <p>1.5.Emetimin radioteleviziv të interpretimit të tij në të gjallë;</p> <p>1.6.Transmetimin publik të interpretimit të tij në të gjallë;</p> <p>1.7.Përpunimin e interpretimit të tij tashmë të fiksuar;</p> <p>1.8.Vënien e interpretimit të tij në dispozicion publikut.</p> <p style="text-align: center;">Neni 132 E drejta e kompensimit</p> <p>1. Interpretuesit kanë të drejtën e hises në kompensimin që merr prodhuesi i fonogramit, për komunikimin publik të interpretimit të tyre nga fonogrami i botuar për qëllime komerciale.</p> <p>2. Interpretuesit që ia kalojnë të drejtën e qiradhënies prodhuesit të fonogramit ose producentit të filmit ruajnë të drejtën e kompensimit përkatës nga qiradhënia.</p>	<p>1.2.Reproduction of his performance in phonograms and videograms;</p> <p>1.3.Distribution of phonograms and videograms containing his performance;</p> <p>1.4.Renting of the phonogram or videogram containing his performance;</p> <p>1.5. Radio and television live transimision of his performance;</p> <p>1.6. Public live transmission of his performance;</p> <p>1.7. Processing of his already fixated performance;</p> <p>1.8. Making his performance available to the public.</p> <p style="text-align: center;">Article 132 The right to compensation</p> <p>1. Performers have the right on their share in compensation that the producers of phonogram receives, for the public communication of their performance from the published phonogram for commercial purposes.</p> <p>2. Performers who assign the right of renting to the producer of phonogram or movie producer, hold the right of relevant compensation from the rent. Performers</p>	<p>1.2.Reprodukciju njegove interpretacije u fonogramima i videogramima;</p> <p>1.3.Raspodelu fonograma i videograma koji sadrže njegovu interpretaciju;</p> <p>1.4.Davanje pod zakup, fonograma ili videograma, koji sadrže njegovo interpretiranje;</p> <p>1.5.Radiotelevizijski prenos njegove interpretacije uživo;</p> <p>1.6.Javno emitovanje njegovog interpretiranja uživo;</p> <p>1.7.Obrađivanje njegove, sada već fiksirane interpretacije;</p> <p>1.8.Stavljanje njegove interpretacije na javno raspolaganje.</p> <p style="text-align: center;">Član 132 Pravo nadoknade</p> <p>1. Izvođači imaju pravo na deo kompenzacije koju uzima proizvođač fonograma, za javno komuniciranje njihove interpretacije, iz objavljenog fonograma u komercijalne svrhe.</p> <p>2. Izvođači koji prenose pravo na zakup, proizvođaču fonograma ili filmskom producentu, zadržavaju pravo odgovarajuće nadoknade od davanja pod</p>
---	--	--



<p>Interpretuesit nuk mund të heqin dorë nga kjo e drejtë.</p> <p>3. Interpretuesi ka të drejtën e hises në kompensim të veçantë nga paragrafi 2 i nenit 38 të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 133 Supozimi i kalimit</p> <p>1. Me lidhjen e kontratës për prodhimin e filmit supozohet se interpretuesi ekskluzivisht dhe pa kufizime ia ka kaluar producentit të filmit të gjitha të drejtat e veta pasurore lidhur me interpretimin, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe, përjashtimisht siç është përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.</p> <p>2. Për secilën të drejtë pasurore që do ta ketë kaluar sipas paragrafit 1 të këtij neni, interpretuesi ka të drejtë të kompensimit përkatës nga ana e producentit të filmit.</p> <p>3. Interpretuesi nuk mund të heq dorë nga e drejta e referuar në paragrafin 2.</p> <p style="text-align: center;">Neni 134 Përfundimi i veprës audiovizuele</p> <p>Nëse interpretuesi refuzon përfundimin e kontributit të vet për veprën audiovizuele</p>	<p>cannot resign from this right.</p> <p>3. Performer has the right of the share of special compensation from paragraph 2 of Article 38 of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 133 Presumption of assignment</p> <p>1. By entering into a contract for the film production, the performer shall be presumed to have assigned to the film producer, exclusively and without limitations, all property rights in his performance, unless otherwise provided by contract, exceptionally as defined in paragraph 3 of this article.</p> <p>2. For each transferred property right according to paragraph 1 of this article, the performer has the right on remuneration from the film producer.</p> <p>3. A performer cannot waive the right referred to in paragraph 2.</p> <p style="text-align: center;">Article 134 Completion of audiovisual work</p> <p>If the performer refuses to complete his contribution for the audiovisual work, or</p>	<p>zakup. Izvođači ne mogu odustati od ovog prava.</p> <p>3. Izvođač ima pravo na deo iz posebne kompenzacije, iz stava 2 člana 38 ovog zakona..</p> <p style="text-align: center;">Član 133 Predpostavka prenosa</p> <p>1. Sklapanjem ugovora za proizvodnju filma, pretpostavlja se da je izvođač ekskluzivno, i bez ograničenja, preneo filmskom producentu, sva svoja imovinska prava u vezi sa interpretacijom, ukoliko se ugovorom drugačije ne predviđa, onako kako je određeno u paragrafu 3 ovog člana.</p> <p>2. Za svako imovinsko pravo koje je preneo, prema paragrafu 1 ovog člana, izvođač ima pravo na odgovarajuću kompenzaciju od strane filmskog producenta.</p> <p>3. Izvođač ne može odustati od referisanog prava u paragrafu 2.</p> <p style="text-align: center;">Član 134 Završavanje audiovizuelnog dela</p> <p>Ako izvođač odbije završavanje svog doprinosa na audiovizuelnom delu, ili nema</p>
--	---	--



<p>ose nuk ka mundësi ta përfundojë atë, nuk mund të kundërshtojë që kontributi i tij tashmë i dhënë të shfrytëzohet për përfundimin e plotë të veprës. Interpretuesi gëzon të drejtat përkatëse për kontributin e deriatëhershëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 135 Përfaqësuesi i ansamblit të interpretuesve</p> <p>1. Lidhur me administrimin e të drejtave të interpretuesve ansamblin e përfaqëson personi që është i autorizuar me shkrim nga shumica e anëtarëve të ansamblit.</p> <p>2. Nëse në interpretim të veprës pos ansamblit marrin pjesë dirigjenti, solistë dhe bartësit e roleve kryesore, të cilët nuk janë njëkohësisht anëtarë të ansamblit, për administrimin e të drejtave nga ky Ligj është i domosdoshëm pajtimi i të gjithë këtyre personave, nëse në kontratë midis tyre dhe ansamblit nuk parashihet ndryshe.</p> <p>3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk kanë të bëjnë me dirigjentët, solistët dhe regjisorët e shfaqjeve teatrore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 136 Interpretimi nga marrdhënia e punës</p>	<p>he is not able to complete it, he cannot oppose for his already given contribution to be used for the full completion of the work. The performer enjoys the related rights for his contribution to that point.</p> <p style="text-align: center;">Article 135 The representative of the performer's ensemble</p> <p>1. Regarding the administration of the performer's rights, the performer's ensemble is represented by a person authorized in written by the majority of ensemble members.</p> <p>2. If on the work performance, except the ensemble, the conductor, solists and main cast actors participate, who are not member of the ensemble at the same time, for the administration of the rights from this law, it is necessary the consent of all these persons, unless otherwise provided by the contract between them and the ensemble.</p> <p>3. Provision of paragraphs 1 and 2 of this article do not concern the conductors, solists and directors of theatre plays.</p> <p style="text-align: center;">Article 136 Performance from working relationship</p>	<p>mogućnosti da ga završi, ne može se osporavati da njegov doprinos, sada već dat, da se iskoristi za potpuno završavanje dela. Izvođač uživa dotična prava za dotadašnji doprinos.</p> <p style="text-align: center;">Član 135 Predstavnik ansambla izvođača</p> <p>1. U vezi administriranja prava izvođača, ansambl predstavlja lice koje je pismeno ovlašćeno od većine članova ansambla.</p> <p>2. Ako u intepretiranju dela, osim ansambla, učestvuju dirigent, solisti i nosioci glavnih uloga, koji istovremeno nisu članovi ansambla, za administriranje prava iz ovog zakona, obavezna je saglasnost svih ovih osoba, ukoliko se ugovorom između njih i ansambla, drugačije ne predviđa se.</p> <p>3. Dispozicije paragrafa 1 i 2 ovog člana ne tiču se dirigenata, solista i režisera pozorišnih predstava.</p> <p style="text-align: center;">Član 136 Interpretacija iz radnog odnosa</p>
---	--	---



<p>Në lidhje me interpretimet që janë rezultat i përmbushjes së detyrave të punës ose udhëzimeve të punëdhënësit gjatë kohëzgjatjes së punësimit, ngjashëm dhe sa u takon <i>mutatis mutandis</i> zbatohen dispozitat e këtij Ligji, që u referohen veprave të autorit të krijuara gjatë marrëdhënies së punës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 137 Kohëzgjatja e mbrojtjes</p> <p>1. Të drejtat pasurore të interpretuesit zgjasin 50 vjet që nga interpretimi i bërë. Nëse interpretimi i fiksuar brenda kësaj periudhe është botuar në mënyrë të ligjshme ose i është komunikuar publikut, të drejtat e interpretuesit zgjasin 50 vjet që nga dita e botimit të parë ose e komunikimit të parë të tillë, varësisht se cili veprim është bërë më përpara.</p> <p>2. Të drejtat morale të interpretuesit zgjasin pa kufizime kohore.</p> <p style="text-align: center;">Nënkreu B</p> <p style="text-align: center;">TË DREJTAT E PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE</p>	<p>On the performances as a result of fulfillment of duties or orders from the employer during the employment term, similar and what belongs to them <i>mutatis mutandis</i>, provisions of this law are implemented, which refer to the author's works created during the working relationship.</p> <p style="text-align: center;">Article 137 Term of protection</p> <p>1. Property rights of the performer shall run for 50 years from the conducted performance. If the performance fixated within this period was published in a legal form or was communicated to the public, performer's rights shall run for 50 years from the day of first publication or first such communication, depending on which was conducted first.</p> <p>2. Moral rights of the performer shall run without any limited timelines.</p> <p style="text-align: center;">Subchapter B</p> <p style="text-align: center;">RIGHTS OF PHONOGRAM PRODUCERS</p>	<p>U vezi sa interpretacijom koja je rezultat ispunjavanja radnih obaveza ili uputstava poslodavaca, tokom trajanja zapošljavanja, slično i koliko pripada <i>mutatis mutandis</i> sprovode se dispozicije ovog zakona, koji se referišu autorskim delima stvorenih u toku radnog odnosa.</p> <p style="text-align: center;">Član 137 Vremensko trajanje zaštite</p> <p>1. Imovinska prava izvođača traju 50 godina od izvršenog interpretiranja. Ako se fiksirano interpretiranje, u toku ovog perioda, objavilo na zakonit način ili komuniciralo sa javnošću, prava izvođača traju 50 godina od dana prvog izdavanja ili takovg prvog komuniciranja, u zavisnosti od toga koja je delatnost prvo izvršena.</p> <p>2. Moralna prava izvođača traju bez vremenskih ograničenja.</p> <p style="text-align: center;">Podglavlje B</p> <p style="text-align: center;">PRAVA PROIZVOĐAČA FONOGRAMA</p>
--	--	---



<p style="text-align: center;">Neni 138 Të drejtat e prodhuesve të fonogrameve</p> <p>1.Prodhuesit e fonogrameve kanë të drejtë ekskluzive të lejojnë apo të ndalojnë:</p> <p>1.1.Riprodhimin e fonogrameve të veta;</p> <p>1.2.Shpërndarjen e fonogrameve të veta;</p> <p>1.3.Qiradhënien e fonogrameve të veta;</p> <p>1.4.Vënien e fonogrameve të veta në dispozicion të publikut;</p> <p>1.5.Përpunimin e fonogrameve të veta.</p>	<p style="text-align: center;">Article 138 The rights of phonograms producers</p> <p>1.Phonogram producers have the exclusive right to allow or prohibit:</p> <p>1.1.Reproductuon of its phonograms;</p> <p>1.2.Distribution of its phonograms;</p> <p>1.3.Lease of its phonograms;</p> <p>1.4.Making its phonograms available to the public;</p> <p>1.5. Processing of its phonograms.</p>	<p style="text-align: center;">Član 138 Prava proizvođača fonograma</p> <p>1.Proizvođači fonograma imaju ekskluzivno pravo da odobre zabrane:</p> <p>1.1 Reprodukciju svojih fonograma,</p> <p>1.2 Raspodelu svojih fonograma,</p> <p>1.3 Davanje pod zakup svojih fonograma,</p> <p>1.4 Stavljanje svojih fonograma na raspolaganju javnosti,</p> <p>1.5 Preradu svojih fonograma</p>
<p style="text-align: center;">Neni 139 E drejta e kompensimit për komunikimin e fonogrameve publikut</p> <p>1. Prodhuesi i fonogramit ka të drejtën e kompensimit për komunikim të publikut të fonogramit të tij të botuar për qëllime komerciale.</p> <p>2. Nëse me kontratë mes prodhuesit të</p>	<p style="text-align: center;">Article 139 Right to remuneration for public communication of the phonograms</p> <p>1. Producer of phonograms shall have the right to remuneration for the communication to the public of his phonogram published for commercial purposes.</p> <p>2. Unless otherwise provided by a contract</p>	<p style="text-align: center;">Član 139 Pravo na kompenzaciju za komuniciranje fonograma javnosti</p> <p>1.Proizvođač fonograma ima pravo na kompenzaciju za komuniciranje sa javnošću objavljen u komercijalne svrhe.</p> <p>2.Ukoliko ugovorom između proizvođača</p>



<p>fonogramit dhe interpretuesve nuk është parashikuar ndryshe, prodhuesi i fonogramit është i detyruar që gjysmën e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni t'ua përcjellë interpretuesve, interpretimet e të cilëve gjenden në fonogramin e tij.</p> <p>3. Në kuptim të këtij neni, fonogramet të botuara për qëllime komerciale konsiderohen fonogramet e vëna në dispozicion të publikut.</p> <p style="text-align: center;">Neni 140 E drejta në kompensim të veçantë</p> <p>Prodhuesit e fonogrameve kanë të drejtën e hises në kompensimin e veçantë nga paragrafi 1 i nenit 38 të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 141 Kohëzgjatja e të drejtave</p> <p>Të drejtat e prodhuesit të fonogrameve zgjasin 50 vjet që nga koha e fiksimit. Nëse brenda kësaj kohe fonogrami është botuar ligjshëm, të drejtat zgjasin 50 vjet që nga botimi i tij i parë. Nëse gjatë kësaj periudhe fonogrami nuk është botuar ligjshëm, por i është komunikuar ligjshëm publikut, të drejtat zgjasin 50 vjet që nga dita e komunikimit të parë të ligjshëm për</p>	<p>between the producer of phonogram and the performers, producer of phonogram is obliged to pay half of remuneration from paragraph 1 of this article to performers whose performances are one his phonogram.</p> <p>3. For the purpose of this article, phonograms made available to the public shall be considered as published for commercial purposes.</p> <p style="text-align: center;">Article 140 Right to special remuneration</p> <p>Producers of phonograms have the right to a portion of special remuneration from paragraph 1 of article 38 of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 141 Term of rights</p> <p>Rights of the producers of phonograms shall run for 50 years from the fixation time. If within this period the phonogram was legally published, the rights shall run for 50 years from its first publication. If during this period the phonogram was not legally published but was legally communicated to public, the rights shall run for 50 years from the day of the first</p>	<p>fonograma i interpretatora nije predviđeno drugačije, proizvođač fonograma je obavezan da polovinu kompenzacije, iz paragrafa 1 ovog člana, prenese na izvođače, interpretacije kojih se nalaze u njegovom fonogramu.</p> <p>3.U smislu ovog člana, objavljeni fonogrami u komercijalne svrhe, smatraće se fonogrami koji se daju na raspolaganje javnosti.</p> <p style="text-align: center;">Član 140 Pravo na posebnu kompenzaciju</p> <p>Proizvođači fonograma imaju pravo na deo posebne komenzacije iz paragrafa 1 člana 38 ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 141 Vremensko trajanje prava</p> <p>Prava proizvođača fonograma traju 50 godina od dana fiksiranja. Ako se tokom ovog vremena fonogram zakonito objavio, prava traju 50 godina od dana prvog objavljivanja. Ako se tokom ovog perioda nije zakonito objavljen, nego je zakonito komuniciran sa javnošću, prava traju 50 godina od dana prvog, zakonitog komuniciranja za javnost.</p>
--	--	---



<p>publikun.</p> <p>Nënkreu C</p> <p>TË DREJTAT E PRODUCENTËVE TË FILMIT</p> <p>Neni 142 Të drejtat e producentëve të filmit</p> <p>1. Producentët e filmit kanë të drejtë ekskluzive të lejojnë apo të ndalojnë:</p> <p>1.1.Riprodhimin e videogrameve të veta;</p> <p>1.2.Shpërndarjen e videogrameve të veta;</p> <p>1.3.Qiradhënien e videogrameve të veta;</p> <p>1.4.Shfaqjen publike të videogrameve të tyre;</p> <p>1.5.Vënien e videogrameve të veta në dispozicion të publikut.</p> <p>Neni 143 E drejta në kompensim të veçantë</p> <p>Producentët e filmit gëzojnë të drejtën e</p>	<p>legal communication to public.</p> <p>Subchapter C</p> <p>RIGHTS OF FILM PRODUCERS</p> <p>Article 142 Rights of film producers</p> <p>1. Film producers have the exclusive right to allow or prohibit:</p> <p>1.1.Reproduction of its videograms;</p> <p>1.2.Distribution of its videograms;</p> <p>1.3.Lease of its videograms;</p> <p>1.4. Public display of its videograms;</p> <p>1.5. Making its videograms available to the public.</p> <p>Article 143 Right to special remuneration</p> <p>Film producers enjoy the right of portion</p>	<p>Podglavlje C</p> <p>PRAVO FILMSKIH PRODUCENATA</p> <p>Član 142 Prava filmskih producenata</p> <p>1. Filmski producenti imaju ekskluzivno pravo da odobre ili zabrane:</p> <p>1.1 Reprodukciju svojih videograma,</p> <p>1.2 Raspodelu svojih videograma,</p> <p>1.3 Davanje pod zakup svojih videograma,</p> <p>1.4 Javnu predstavu svojih videograma,</p> <p>1.5 Stavljanje svojih videograma na raspolaganje za javnosti.</p> <p>Član 143 Pravo na posebnu kompenzaciju</p> <p>Producenti filma imaju pravo na deo</p>
---	--	---



<p>hises në kompensim të veçantë nga paragrafi 2 i nenit 38 të këtij Ligji.</p> <p>Neni 144 Kohëzgjatja e të drejtave</p> <p>Të drejtat e producentëve të filmit zgjasin 50 vjet që nga fiksimi i parë i videogramit. Nëse gjatë kësaj periudhe videogrami është botuar ose i është komunikuar ligjshëm publikut, të drejtat e producentit të filmit zgjasin 50 vjet që nga dita e botimit të parë ose e komunikimit të parë publikut, varësisht se cili veprim është bërë më përpara.</p> <p>Nënkreu D</p> <p>TË DREJTAT E SHERBYESVE MEDIAL AUDIOVIZUEL</p> <p>Neni 145 Të drejtat e shërbyesve medial audiovizuel</p> <p>1. Organizata transmetuese ka të drejtë ekskluzive të lejojë apo të ndalojë:</p> <p>1.1.Fiksimin e emisioneve të veta;</p>	<p>of special remuneration from paragraph 2 of article 38 of this law.</p> <p>Article 144 Term of rights</p> <p>Rights of film producers shall run for 50 years from the first fixation of the videogram. If during this period the videogram was published or communicated legally to public, the rights of film producers shall run for 50 years from the day of its first publication or first communication to public, depending on which activity was conducted first.</p> <p>Subchapter D</p> <p>RIGHTS OF AUDIOVISUAL MEDIA SERVICE</p> <p>Article 145 Rights of Audiovisual media service</p> <p>1. A broadcasting organization shall have the exclusive right to allow or prohibit:</p> <p>1.1.the fixation of its broadcast;</p>	<p>posebne posebne kompenzacije, iz paragrafa 2 člana 38 ovog zakona.</p> <p>Član 144 Vremensko trajanje prava</p> <p>Prava filmskih producenata traju 50 godina od prvog fiksiranja videograma. Ako se tokom ovog perioda, videogram objavio ili zakonito komunicirao sa javnošću, prava filmskih producenta traju 50 godina, od dana prvog objavljivanja ili prvog komuniciranja sa javnošću, u zavisnosti koja je delatnost najpre izvršena.</p> <p>Poglavlje D</p> <p>PRAVA AUDIOVIZUELNA MEDIJSKA USLUGA MEDIJSKA USLUGA</p> <p>Član 145 Prava Audiovizuelna medijska usluga</p> <p>1. Organizacija za prenos programa ima ekskluzivno pravo da odobri ili zabrani :</p> <p>1.1. Fiksiranje svojih emisija;</p>
---	---	--



<p>1.2.Riprodhimin e emisioneve të veta të fiksuara;</p> <p>1.3.Shpërndarjen e fiksimëve të emisioneve të veta;</p> <p>1.4.Riemetimin radioteleviziv të emisioneve të veta;</p> <p>1.5.Emetimin e mëtejme të emisioneve të veta, kur kjo bëhet në ato vende ku hyrja e publikut është me pagesë;</p> <p>1.6.Vënien në dispozicion publikut të emisioneve të veta të fiksuara.</p> <p style="text-align: center;">Neni 146 Kohëzgjatja e të drejtave</p> <p>Të drejtat e shërbyesve medial audiovizuel zgjasin 50 vjet që nga dita e emetimit të parë radioteleviziv të emisionit të tyre.</p> <p style="text-align: center;">Nënkreu E</p> <p style="text-align: center;">TË DREJTAT E PRODHUESVE TË BAZAVE TË TË DHËNAVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 147 Mbrojtja e bazës së të dhënave</p> <p>Mbrojtja e bazës së të dhënave apo e përmbajtjeve të saj zbatohet pavarësisht nga mbrojtja autor-juridike ose mbrojtja</p>	<p>1.2.the reproduction of its fixated broadcasts;</p> <p>1.3.the distribucion of fixations of its broadcasts;</p> <p>1.4.the radiotelevision re-broadcasting of its broadcasts;</p> <p>1.5.Further broadcasting of its broadcasts, if this is done in public places accessible with payment;</p> <p>1.6. Making available its fixated broadcasts to the public.</p> <p style="text-align: center;">Article 146 Term of rights</p> <p>Rights of the Audiovisual media service shall run for 50 years from the day of its first radiotelevision broadcast.</p> <p style="text-align: center;">Subchapter E</p> <p style="text-align: center;">RIGHTS OF THE DATA BASES PRODUCERS</p> <p style="text-align: center;">Article 147 Protection of data base</p> <p>Protection of the data base or its contents is implemented despite the author-judicial or other judicial protection The rights that</p>	<p>1.2. Reprodokciju svojih fiksiranih emisija;</p> <p>1.3.Raspodelu svojih fiksiranih emisija;</p> <p>1.4.Radiotelevizijsko ponavljanje emitovanja svojih emisija;</p> <p>1.5. Dalje emitovanje svojih emisija, kada se to vrši na onim mestima gde se ulaz za javost plaća;</p> <p>1.6. Stavljanje svojih fiksiranih emisija na raspolaganju za javnost.</p> <p style="text-align: center;">Član 146 Vremensko trajanje prava</p> <p>Prava Audiovizuelna medijska usluga traju 50 godina od dana prvog radiotelevizijskog emitovanja njihove emisije.</p> <p style="text-align: center;">Poglavlje E</p> <p style="text-align: center;">PRAVA PROIZVOĐAČA BAZE PODATAKA</p> <p style="text-align: center;">Član 147 Zaštita baze podataka</p> <p>Zaštita baze podataka ili njenih sadržaja sprovodi se nezavisno od autorsko-pravne zaštite ili druge pravne zaštite. Prava koja</p>
--	---	---



<p>tjetër juridike. Të drejtat që ekzistojnë lidhur me materialin e ngërthyer në bazën e të dhënave dhe të shfrytëzimit të tij mbeten të paprekshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 148 Objekti i mbrojtjes</p> <p>1. Mbrojtja e bazës së të dhënave në kuptim të këtij kapitulli zbatohet:</p> <p>1.1. Ndaj tërë përmbajtjes të bazës së të dhënave;</p> <p>1.2. Ndaj çdo pjese thelbësore kualitative dhe kuantitative, si dhe kualitative ose kuantitative të përmbajtjes së saj;</p> <p>1.3. Ndaj pjesëve jothelbësore kualitative dhe kuantitative, si dhe kualitative ose kuantitative të përmbajtjes së saj, kur ato përdoren në mënyrë të përsëritur dhe sistematike, për çka bie ndesh me shfrytëzimin normal të kësaj baze të të dhënave ose me këtë preken së tepërmi interesat ekzistuese të ligjshme të prodhuesit të bazës së të</p>	<p>exist regarding the interlaced material on the data base and its use remain inaccessible.</p> <p style="text-align: center;">Article 148 Target of protection</p> <p>1. For the purpose of this chapter data base protection is implemented:</p> <p>1.1. Against the whole content of the data base;</p> <p>1.2. Against each essential qualitative and quantitative part, and qualitative or quantitative of its content;</p> <p>1.3. Against nonessential qualitative and quantitative parts, and qualitative or quantitative of its content, when used repetively and systematically, which is in contradiction with the normal use of this data base or by doing this the existing legal interests of the data base producer are overly accessible.</p>	<p>postoje u vezi sa spojenim materijalom u bazi podataka i njihovom korišćenju, ostaju nedodirljiva.</p> <p style="text-align: center;">Član 148 Objekat zaštite</p> <p>1. Zaštita baze podataka u smislu ovog poglavlja sprovodi se:</p> <p>1.1. Prema ukupnoj sadrž baze podataka;</p> <p>1.2. Prema svakom suštinskom kvalitativnom i kvantitativnom delu ili njenim kvalitativnim ili kvantitativnim sadržajem;</p> <p>1.3. Prema nesuštinskim kvalitetnim i Kvantitetnim delovima ka i Kvalitetnom i kvantitetnom sadržaju, kada se oni upotrebljavaju na ponovljeni način i sistematski, što se suprotstavlja normalnom korišćenju ove baze podataka ili se ovim previše dodiraju postojeći, zakonski interesi proizvođača baze podataka.</p>
---	--	--



